



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR

DHOMËN EKONOMIKE KOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 2
Parimet e përgjithshme

Dhoma Ekonomike Kombëtare, dhomat ekonomike rajonale dhe këshillat sektorial e ndërsektorial udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, lirisë së organizimit, vetërregullimit, mbrojtjes së lirive dhe të drejtave ekonomike të subjekteve tregtare, si dhe të bashkëpunimit me organet e administratës publike.

Neni 3
Dhoma Ekonomike Kombëtare

- Dhoma Ekonomike Kombëtare e Shqipërisë ngrihet dhe funksionon në bazë të këtij ligji, si person juridik publik i krijuar në bazë të këtij ligji.
- Dhoma Ekonomike Kombëtare përbëhet nga anëtarët e saj që janë

subjektet tregtare të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dhoma Ekonomike Kombëtare e ka selinë në Tiranë.

4. Dhoma Ekonomike Kombëtare, në përputhje me statutin e saj, mund të themelojë përfaqësi në një shtet tjetër.

5. Dhoma Ekonomike Kombëtare ka stemën dhe vulën sipas përcaktimeve të statudit.

Neni 4

Dhoma Ekonomike Rajonale

1. Dhoma Ekonomike Rajonale është person juridik publik, që nuk ushtron aktivitet fitimprurës dhe ka statutin e saj.

2. Numri i Dhomave Ekonomike Rajonale dhe shpërndarja e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, përcaktohen me vendim të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen referuar ndarjes administrative territoriale në nivel qarku ose të ngjashëm.

3. Selia e Dhomës Ekonomike Rajonale përcaktohet në statutin e saj.

4. Dhoma Ekonomike Rajonale ka stemën dhe vulën sipas përcaktimeve të statudit të saj.

Neni 5

Këshillat sektorial dhe ndërsektorial

1. Këshillat kombëtarë sektorial dhe ndërsektorial mund të krijohen për një ose më shumë sektorë kryesor të ekonomisë, pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare, të balancuar në numër me dhomat ekonomike rajonale.

2. Pranë çdo dhome ekonomike rajonale mund të krijohen këshillat rajonal sektorial dhe ndërsektorial, sipas natyrës të aktivitetit ekonomik dhe peshës që kanë në rajon.

3. Sektorët kryesor të ekonomisë dhe nënsektorët për të cilët do të ngrihen këshillat sektorial dhe ndërsektorial përcaktohen në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 6

Këshilli konsultativ

1. Këshilli Konsultativ ngrihet si organ konsultativ pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare. Ky Këshill ka rol rekomandues për politika në fusha të veçanta, bashkëpunon me organet e Dhomës Ekonomike Kombëtare, si dhe mund të organizojë aktivitete dhe inisiativa të përbashkëta me sistemin e dhomave. Në mbështetje të këtij Këshilli mund të ngrihet një sekretariat teknik, i cili miratohet nga Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare.

2. Pjesëmarrës të këtij këshilli mund të jenë anëtarët e dhomave të tjera ose organizatave jofitimprurëse që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, që nuk janë krijuar sipas këtij ligji.

3. Rregullat e detajuara për pjesëmarrjen në Këshillin Konsultativ, organizimin dhe funksione të tjera të Këshillit, përcaktohen në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 7

Përdorimi i emërtimeve

1. Përdorimi i emërtimeve “Dhomë Ekonomike”, “Dhomë Ekonomike Kombëtare” dhe “Dhomë Ekonomike Rajonale” është i rezervuar vetëm për subjektet, që krijohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Emërtimet e mësipërme lejohen të përdoren edhe nga ato shoqata të bashkimit vullnetar të bizneseve, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tyre, si dhe promovimin e tregtisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër, të cilat njihen zyrtarisht nga institucionet përkatëse simotra të vendit tjetër dhe autorizohen nga Dhoma Ekonomike Kombëtare.

KREU II

OBJEKTI I VEPRIMTARISË DHE FUNKSIONET

Neni 8

Objekti i veprimtarisë dhe funksionet e Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare bashkërendon punën e dhomave ekonomike rajonale, këshillave sektorial dhe ndërsektorial në nivel kombëtar, si dhe ka të drejtë të bashkëpunojë me dhomat bilaterale e multilaterale, grupimet dhe organizatat jofitimprurese, si dhe dhomat profesionale që nuk janë krijuar sipas këtij ligji.

2. Dhoma Ekonomike Kombëtare ushtron këto funksione:

a) përfaqëson dhe promovon interesat e përgjithshëm dhe të ligjshme të anëtarëve të saj;

b) përfaqëson sistemin e dhomave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

c) nxit marrëdhëniet ndërmjet këshillave sektorial e ndërsektorial dhe Dhomave Ekonomike Rajonale, si dhe marrëdhëniet e tyre me organizmat simotra të vendeve të tjera;

ç) mbledh, përpunon dhe shpërndan të dhëna tregtare në nivel kombëtar, duke krijuar sistemin e vet të të dhënave në regjistrin informativ të sipërmarrjes (RIS) në përputhje me parashikimet e nenit 12, të këtij ligji, si dhe të bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe organe të tjera publike për shkëmbimin e të dhënave;

d) jep mendime, propozime dhe shprehet për nismat ligjore apo politikat publike të ndërmarra nga Qeveria, përmbajtja e të cilave lidhet me interesat e anëtarëve të saj;

dh) nxit veprimtarinë ekonomike dhe konkurrencën e ndershme në ekonomi;

e) nxit bashkëpunimin ekonomik tregtar me jashtë dhe ndërkombëtarizimin, duke promovuar potencialet ekonomike vendase dhe tërheqjen e investimeve të huaja;

ë) shkëmben informacion me organet e administratës publike, për nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve;

f) ofron këshillime ligjore dhe biznesi për anëtarët e saj;

g) organizon, administron dhe financon ekspozita dhe panaire, si dhe administron kalendarin dhe regjistrin e panairove që organizohen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi;

gj) krijon projekte dhe programe financimi për të mbështetur gratë në sipërmarrje, të rinjtë, projektet inovative, rritjen e bashkëpunimit me diasporën, ekonominë e gjelbër etj.;

h) merr pjesë dhe aplikon në projekte dhe programe zhvillimore ekonomike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

i) krijon Qendrën e Integritimit Ekonomik Europian dhe ndihmon në integrimin europian të vendit, duke bashkëpunuar në proceset e përafrimit të legjislacionit, informimit të vazhdueshëm të anëtarëve të saj për Tregun e Përbashkët Europian dhe legjislacionin e Bashkimit Europian, si dhe ofron trajnime të vazhdueshme në fusha që përbëjnë interes për proceset integruese të vendit;

l) ofron programe trajnimi dhe kualifikimi të vazhdueshme profesionale për fuqizimin dhe aftësimin e punonjësve dhe sipërmarrësve, si dhe të ndërmerri nisma për anketa periodike për të evidentuar fushat dhe tematikat që kanë interes anëtarët e Dhomës;

ll) mund të krijojë Qendrën e Ndërmjetësimit Ekonomik, nxit dhe ndihmon anëtarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet rrugës së ndërmjetësimit në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin;

m) krijon Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, nxit dhe ndihmon anëtarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet rrugës së arbitrazhit në përputhje me legjislacionin për arbitrazhin;

n) publikon në faqen zyrtare, brenda 3 muajve të parë të çdo viti, raportin publik vjetor për vitin pararendës mbi veprimtarinë e Dhomës Ekonomike Kombëtare, ku përfshihen së paku të dhëna për indeksin e klimës së biznesit, ecurinë e programit të zhvillimit të biznesit për arritjen e standardeve të detyrueshme të integritimit në Bashkimin Evropian, vlerësimin e performancës vjetore të dhomave ekonomike rajonale, Këshillave sektorial e ndërsektorial, propozimet për përmirësimet ligjore dhe statusin e tyre, problematikat për konkurrencën e tregut të lirë, trajnimet dhe kualifikimet e kryera, çështjet e zgjidhura të konflikteve mes bizneseve, tregues të matshëm për hapjen e eksporteve dhe suksesin e pjesëmarrjes në panaire, të dhëna për bashkëpunimin ndërkombëtar, të ardhurat dhe shpenzimet. Përpara publikimit, raporti vjetor i dërgohet ministrit përgjegjës për sipërmarrjen;

nj) çdo veprimtari apo shërbim tjetër që i ngarkohen me ligj dhe akt nënligjor apo mund t'i delegohen nga organet publike me marrëveshje.

Neni 9

Objekti i veprimtarisë dhe funksionet e Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Dhoma Ekonomike Rajonale përfaqëson interesat e subjekteve tregtare në nivel rajoni, bashkërendon punën e këshillave sektorial dhe ndërsektorial në nivel rajoni, si dhe ka të drejtë të bashkëpunojë me dhomat bilaterale dhe grupimet.

2. Dhoma Ekonomike Rajonale ushtron këto funksione:

a) shkëmben informacion me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare;

b) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare shkëmben informacion me organet e administratës publike, për nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve në rajonin ku ushtron veprimtarinë;

c) përfaqëson interesat ekonomike dhe juridike të anëtarëve që janë në juridiksionin e saj;

ç) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare, bashkëpunon me organe të tjera publike, donatorë, organizata jofitimprurëse për zhvillimin e projekteve dhe programeve që kanë ndikim në juridiksionin e saj;

d) mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore për anëtarët në juridiksionin e saj;

dh) në koordinim me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare jep mendime, propozime dhe vlerësime për nismat ligjore apo politikatat publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e çdo dege dhe gjithë subjekteve tregtarë;

e) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare propozon nisma ligjore me karakter ekonomik në organet e qeverisjes vendore;

ë) këshillon, mbështet dhe përfaqëson anëtarët e saj brenda fushës që përcakton ky ligj për çështjet ekonomike;

f) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare organizon dhe mbështet pjesëmarrjen në panaire dhe ekspozita me karakter vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar;

g) siguron informacion për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me themelimin dhe zgjerimin, kapacitetet teknologjike dhe eksportuese të bizneseve, për këshillimin dhe bashkëpunimin në projekte në përfitim të anëtarësisë së saj;

gj) ushtron çdo veprimtari apo shërbim tjetër, që i ngarkohet nga Dhoma Ekonomike Kombëtare.

Neni 10

Objekti i veprimtarisë dhe funksionet e këshillave sektorial dhe ndërsektorial

1. Këshillat sektorial dhe ndërsektorial pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale përfaqësojnë interesat e

subjekteve tregtare sipas sektorëve të ekonomisë ku ushtrojnë veprimtarinë dhe përcjellin kërkesat dhe mendimet e tyre pranë pushtetit qendror dhe vendor, në koordinim me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare. Anëtarësia e tyre përcaktohet sipas kodit të aktivitetit NACE dhe numrit të subjekteve tregtare sipas kategorive të veçanta të biznesit.

2. Këshillat sektorial dhe ndërsektorial ushtrojnë këto funksione:

a) shkëmbejnë informacion me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale;

b) mbledhin dhe përpunojnë të dhëna statistikore për subjektet tregtare sipas sektorëve;

c) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare japin mendime, propozime dhe vlerësime për nismat ligjore apo politikat publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e sektorit;

ç) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare propozojnë nisma ligjore dhe politika me karakter ekonomik sektorial në organet e qeverisjes qendrore dhe vendore;

d) në dijeni me organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare përfaqësojnë interesat anëtarëve të tyre me palët e treta;

dh) ushtrojnë çdo veprimtari apo shërbim tjetër, që i ngarkohet nga Dhoma Ekonomike Kombëtare.

KREU III ANËTARËSIA

Neni 11

Regjistrimi në Dhomën Ekonomike Kombëtare

1. Regjistrimi në Dhomën Ekonomike Kombëtare është i detyrueshëm për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të subjekteve që janë të regjistruara në një Dhomë apo urdhër profesional të krijuar me ligj të veçantë.

2. Subjektet tregtare, biznes i vogël, paguajnë një tarifë vjetore regjistrimi në vlerën 1000 (njëmijë) lekë. Tarifa vjetore e regjistrimit, për subjektet e tjera tregtare sipas kategorive përkatëse, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare bazuar në kriteret e përcaktuara në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

3. Tarifa vjetore e regjistrimit në Dhomë për të gjitha subjektet tregtare që regjistrohen për herë të parë në Qendrën Kombëtare të Biznesit është 1000 (njëmijë) lekë.

4. Tarifa vjetore e regjistrimit për anëtarët e dhomave bilaterale dhe multilaterale është 1000 (njëmijë) lekë. Anëtarët e dhomave dhe shoqatave bilaterale, vërtetojnë dhe njoftojnë anëtarësinë apo regjistrimin e tyre në këto dhoma, pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare brenda datës 30 prill të çdo viti.

5. Anëtarët e dhomave dhe shoqatave bilaterale, paguajnë tarifën vjetore sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni në rastet kur shfaqin vullnetin për të

kandiduar për organet drejtuese sipas rregullimeve të këtij ligji dhe Statutit të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

6. Anëtarët e Dhomës Ekonomike Kombëtare pajisen me kartën e regjistrimit nga Dhoma, pasi të kenë kryer pagesën e plotë të regjistrimit, sipas rregullave të detajuara në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

7. Të gjitha subjektet tregtare që regjistrohen për herë të parë, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, detyrohen të depozitojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në zbatim të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, edhe dokumentin që vërteton pagesën e tarifës vjetore të regjistrimit në dhomë.

8. Anëtarët e Dhomës Ekonomike Kombëtare paguajnë tarifën vjetore të regjistrimit brenda datës 30 prill të çdo viti. Anëtarët që nuk kanë paguar tarifën vjetore të regjistrimit nuk marrin pjesë në procesin zgjedhor për organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial, si dhe nuk përfitojnë shërbimet e ofruara nga Dhoma Ekonomike Kombëtare.

9. Detyrimet e parashikuara në këtë nen fillojnë efektet 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Regjistri

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare mban regjistrin elektronik të anëtarësisë. Forma e këtij regjistri dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen me vendim të Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

2. Dhoma Ekonomike Rajonale mban regjistrin e subjekteve tregtare që ka në juridiksionin e saj. Forma e këtij regjistri dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen me vendim të Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

3. Të dhënat e regjistrit të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe të dhomave ekonomike rajonale duhet të jenë në formë elektronike dhe ruhen sipas rregullave të përcaktuara nga statuti i Dhomës Ekonomike Kombëtare, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

4. Subjektet e regjistruara pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare kanë detyrimin për të ndarë të dhëna periodike sipas kërkesave të përcaktuara në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

KREU IV

ORGANET DHE KOMPETENCAT

SEKSIONI 1

Neni 13

Organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare, janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare;

- b) Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- c) Presidenti i Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- ç) Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare zgjidhet çdo 4 vjet. Ajo ka jo më shumë se 121 anëtarë. Përfaqësimi i anëtarëve të secilës Dhomë Ekonomike Rajonale në Asamblenë e Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Kombëtare është në proporcion me numrin e anëtarëve që ato përfaqësojnë.

2. Kriteri për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme në Dhomën Ekonomike Kombëtare nga Dhomat Ekonomike Rajonale do të jetë sipas numrit të subjekteve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit për selitë e subjekteve tregtare. Rregullat dhe procedurat e detajuara për zgjedhjen caktohen në statut.

3. Anëtarët e asamblesë duhet të jenë të autorizuar nga Dhoma Ekonomike Rajonale që përfaqësojnë, për të ushtruar të drejtën e votës në Asamblenë e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

4. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit. Të drejtën për ta mbledhur asamblenë e kanë Presidenti i Dhomës Ekonomike Kombëtare, Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare apo kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të saj.

5. Presidenti i Dhomës Ekonomike Kombëtare drejton mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 15

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Kombëtare

Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare ka këto kompetenca:

- a) shqyrton dhe përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- b) miraton statutin dhe ndryshimet e tij;
- c) zgjedh me votim të fshehtë dhe me shumicën e anëtarëve që marrin pjesë në zgjedhje, anëtarët e Bordit që nuk janë kryetarë të dhomave rajonale dhe këshillave kombëtarë sektorial e ndërsektorial, Presidentin dhe anëtarët e Komisionin e Auditimit.
- ç) miraton programin dhe buxhetin vjetor;
- d) shqyrton e miraton raportin vjetor ekonomik dhe financiar të Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- dh) miraton akte të ndryshme për funksionimin dhe organizimin e Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- e) kompetenca të tjera të caktuara me këtë ligj.

Neni 16

Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare përbëhet nga Presidenti dhe nga një numër anëtarësh, të cilët nuk mund të jenë më pak se 7, por jo më shumë se 25 anëtarë. Numri i anëtarëve të Bordit caktohet në statut.

2. Kryetarët e dhomave ekonomike rajonale dhe të këshillave kombëtarë sektorial e ndërsektorial janë anëtarë të Bordit. Anëtarët e tjerë zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme çdo 4 vjet, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Rregullat e procedurat e detajuara për zgjedhjen caktohen në statut.

3. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Presidenti drejton mbledhjen e Bordit dhe në rast mungese autorizon njërin nga anëtarët për drejtimin e mbledhjes.

5. Bordi mblidhet të paktën një herë në 6 muaj nga Kryetari ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve.

6. Në mbledhjet e Bordit ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i caktuar nga Ministri përgjegjës për sipërmarrjen, si vëzhgues dhe pa të drejtë vote.

Neni 17

Kompetencat e Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare është organi ekzekutiv i Dhomës dhe ka këto kompetenca:

a) miraton programet e punës, që lidhen me detyrat dhe objektivat e Dhomës Ekonomike Kombëtare;

b) miraton strukturën organizative të aparatit administrativ të Dhomës Ekonomike Kombëtare, funksionet dhe pagat e punonjësve të këtij aparati;

c) miraton rregulloren e brendshme të aparatit administrativ të Dhomës Ekonomike Kombëtare në përputhje me këtë ligj dhe statutin;

ç) shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin përpara se t'i paraqitet asamblesë për miratim;

d) cakton rregullat për përdorimin e fondeve dhe administrimin e tyre;

e) propozon ndryshimet në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare;

ë) përcakton rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së Dhomës Ekonomike Kombëtare;

f) merr vendime për të gjitha çështjet që shtrohen për shqyrtim në Bord nga kryetari ose 1/3 e anëtarëve;

g) kompetenca të tjera të caktuara me këtë ligj.

2. Bordi është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të asamblesë dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 18

Presidenti i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Presidenti i Dhomës Ekonomike Kombëtare përfaqëson Dhomën Ekonomike Kombëtare me të tretët.
2. Presidenti emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare me propozim të 1/5 të anëtarëve të saj, me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim.
3. Presidenti zgjidhet me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.
4. Presidenti shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare me propozim të 1/3 të anëtarëve të saj, me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim.
5. Presidenti drejton mbledhjen e Asamblesë dhe të Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe gëzon të drejtën e një vote.
6. Presidenti është përgjegjës për drejtimin strategjik të Dhomës Ekonomike Kombëtare.
7. Presidentit mund t'i caktohen me Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare detyra të tjera, që nuk bien ndesh me kompetencat e organeve të tjera të përcaktuara sipas këtij ligji.

Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Ekonomike Kombëtare emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare me propozim të Presidentit, me mandat 5 vjeçar me të drejtë riemërimi.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës ka këto kompetenca:
 - a) përfaqëson në nivel administrativ Dhomën Ekonomike Kombëtare me të tretët;
 - b) organizon, drejton dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti aktivitetin e administratës së Dhomës, si dhe ndan detyrat për çdo departament apo njësi tjetër të kësaj administrate, sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme të Dhomës;
 - c) propozon strukturën organizative të aparatit administrativ të Dhomës, funksionet dhe pagat e punonjësve të këtij aparati;
 - ç) propozon rregulloren e brendshme të aparatit administrativ të Dhomës.
 - d) përgatit programin vjetor financiar dhe buxhetin përpara se t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - dh) paraqet çdo vit para Bordit dhe Asamblesë së Përgjithshme raportin vjetor të aktivitetit të Dhomës si dhe projektprogramin për vitin e ardhshëm.

Neni 20

Humbja e mandatit në organet Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Mandati i personave të zgjedhur në organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare humbet kur:

- a) dorëhiqen;
 - b) shkelin dispozitat e këtij ligji dhe kuadrit ligjor në fuqi;
 - c) shkelin statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Dhomave Ekonomike Rajonale;
 - ç) kur dënohen me vendim gjykate të formës së prerë;
 - d) për çdo arsye tjetër të ligjshme.
2. Humbja e mandatit vendoset nga organi që i ka zgjedhur.
3. Procedurat e zëvendësimit të tyre përcaktohet në statut.

Neni 21

Komisioni i auditit i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare funksionon Komisioni i Auditit, i përbërë nga 5 anëtarë ekspertë të jashtëm, të cilët zgjidhen me shumicën e votave nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare me propozim të Bordit Drejtues të Dhomës Ekonomike Kombëtare. Anëtarët ekspertë të jashtëm të Komisionit zgjidhen me mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje një herë.

2. Komisioni i Auditit ushtron kontroll financiar të brendshëm në Dhomën Ekonomike Kombëtare, dhomat ekonomike rajonale, si dhe këshillat sektorial dhe ndërsektorial.

3. Pas miratimit në Asamblenë e Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Kombëtare, raporti i komisionit të auditimit i dërgohet për njoftim ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

4. Procedura e detajuar e zgjedhjes dhe kompetencat e Komisionit të Auditit përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

5. Për auditimin e pasqyrave financiare të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale, Dhoma Ekonomike Kombëtare lidh marrëveshje me një kompani auditimi ndërkombëtare të certifikuar.

SEKSIONI 2

Neni 22

Organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Rajonale, janë:
- a) Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale;
 - b) Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale;
 - c) Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale;
 - ç) Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Ekonomike Rajonale.

Neni 23

Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale zgjidhet çdo 4 vjet. Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i Dhomës Ekonomike Rajonale. Numri i anëtarëve të asamblesë është jo më pak se 21 dhe jo më shumë se 71, në proporcion me numrin e bizneseve të rajonit. Procedura dhe rregullat e detajuara për procesin e zgjedhjes përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

2. Anëtarët e asamblesë rajonale janë persona, që kanë zotësi të plotë për të vepruar, gëzojnë reputacion në komunitetin e biznesit të zonës që përfaqësojnë dhe nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale.

3. Anëtarët e asamblesë rajonale duhet të jenë të autorizuar nga subjekti tregtar që përfaqësojnë, për të ushtruar të drejtën e votës në asamblenë e Dhomës. Çdo subjekt tregtar ka të drejtë të përfaqësohet në asamblenë e Dhomës vetëm nga një anëtar.

4. Asambleja rajonale mblidhet të paktën një herë në vit. Të drejtën për ta mbledhur asamblenë e kanë Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale, Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale apo kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të saj.

5. Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale drejton mbledhjet e Asamblesë rajonale.

Neni 24

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Ekonomike Rajonale

Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale ka këto kompetenca:

- a) shqyrton dhe përcakton drejtimit kryesore të veprimtarisë së Dhomës Ekonomike Rajonale;
- b) miraton statutin e Dhomës Ekonomike Rajonale;
- c) zgjedh nga anëtarët, me votim të fshehtë me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në zgjedhje, anëtarët e Bordit që nuk janë kryetarë të këshillave rajonal sektorial dhe ndërsektorial, Kryetarin, si dhe përfaqësuesit e Dhomës Ekonomike Rajonale në Asamblenë e Dhomës Ekonomike Kombëtare;
- ç) shqyrton e miraton raportin vjetor të veprimtarive në përgjithësi dhe të veprimtarisë financiare të Dhomës Ekonomike Rajonale;
- d) raporton në Bordin e Dhomës Ekonomike Kombëtare për projektet, programet, nismat dhe aktivitetet që krijojnë marrëdhënie më palë të treta;
- dh) miraton akte të ndryshme për mirëfunksionimin organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Rajonale.

Neni 25

Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale përbëhet nga jo më shumë se 15 anëtarë të cilët zgjidhen çdo 4 vjet, me të drejtë rizgjedhje një herë. Kryetarët e këshillave rajonal sektorial dhe ndërsektorial janë anëtarë të Bordit. Anëtarët e tjerë zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme Rajonale.

2. Bordi mblidhet të paktën një herë në 6 muaj nga Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve. Kryetari drejton mbledhjet dhe në rast mungese autorizon një nga anëtarët.

3. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 26

Kompetencat e Bordit të Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale është organi ekzekutiv i Dhomës Ekonomike Rajonale dhe ushtron këto kompetenca:

a) miraton programet e punës, që lidhen me objektivat dhe kompetencat e Dhomës Ekonomike Rajonale;

b) miraton strukturën organizative dhe personelin tekniko-administrativ të Dhomës Ekonomike Rajonale, si dhe funksionet dhe pagat e punonjësve;

c) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të administratës së Dhomës Ekonomike Rajonale;

ç) propozon ndryshimet në statutin e Dhomës Ekonomike Rajonale;

d) shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin, përpara se t'i paraqitet asamblesë për miratim;

dh) kompetenca të tjera të caktuara me këtë ligj.

Neni 27

Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Kryetari i Dhomës Ekonomike Rajonale përfaqëson Dhomën Ekonomike Rajonale me të tretët.

2. Kryetari emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale me propozim të 1/5 të anëtarëve të saj, me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim.

3. Kryetari zgjidhet me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

4. Kryetari shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale me propozim të 1/3 të anëtarëve të saj, me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim.

4. Kryetari drejton mbledhjen e Asamblesë të Përgjithshme dhe Bordit të Dhomës Ekonomike Rajonale dhe gëzon të drejtën e një vote.

5. Kryetari është përgjegjës për drejtimin strategjik në rajon të Dhomës Ekonomike Rajonale.

Neni 28

Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Ekonomike Rajonale zgjidhet dhe shkarkohet nga Bordi i Dhomës Ekonomike Rajonale me propozim të Kryetarit të Dhomës Ekonomike Rajonale, me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

2. Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

a) përfaqëson në nivel administrativ Dhomën Ekonomike Rajonale me të tretët;

b) organizon, drejton dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti aktivitetin e administratës së Dhomës, si dhe ndan detyrat për çdo departament apo njësi tjetër të kësaj administrate, sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme të Dhomës;

c) propozon strukturën organizative të aparatit administrativ të Dhomës, funksionet dhe pagat e punonjësve të këtij aparati;

ç) propozon rregulloren e brendshme të aparatit administrativ të Dhomës;

d) përgatit programin vjetor financiar dhe propozon buxhetin përpara se t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme Rajonale për miratim;

dh) paraqet çdo vit para Bordit të Dhomës Ekonomike Rajonale dhe Asamblesë së Përgjithshme Rajonale raportin vjetor të aktivitetit të Dhomës si dhe projektprogramin për vitin e ardhshëm.

Neni 29

Humbja e mandatit në organet Dhomës ekonomike rajonale

1. Mandati i personave të zgjedhur në organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Rajonale humbet kur:

a) dorëhiqen;

b) shkelin dispozitat e këtij ligji dhe kuadrit ligjor në fuqi;

c) shkelin statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Dhomave Ekonomike Rajonale;

ç) kur dënohen me vendim gjykatë të formës së prerë;

d) për çdo arsye tjetër të ligjshme.

2. Humbja e mandatit vendoset nga organi që i ka zgjedhur.

3. Procedurat e zëvendësimit të tyre përcaktohet në statut.

Neni 30

Struktura organizative e këshillave sektorial dhe ndërsektorial

1. Këshillat kombëtarë sektorial dhe ndërsektorial që ngrihen pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare kanë në përbërje kryetarët e këshillave rajonal sektorial e ndërsektorial dhe përfaqësues të anëtarësisë që zgjidhen me votë nga këshillat rajonal pranë dhomave ekonomike rajonale sipas peshës që zënë në

ekonominë e rajonit.

2. Mbledhja e këshillave kombëtare sektorial dhe ndërsektorial drejtohet nga Kryetari i tyre, i cili zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të anëtarëve dhe përfaqëson këshillin në Bordin e Dhomës Ekonomike Kombëtare. Kryetari ka mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje një herë.

3. Këshillat rajonale sektoriale dhe ndërsektoriale që ngrihen pranë dhomave ekonomike rajonale kanë në përbërje anëtarë me kod aktiviteti NACE dhe subjekte tregtare sipas kategorive të veçanta të biznesit që përputhet me objektin e veprimtarisë së këshillit sektorial dhe ndërsektorial.

4. Mbledhja e këshillave rajonale sektoriale dhe ndërsektoriale drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit Rajonal Sektorial dhe përfaqëson këshillin rajonal sektorial e ndërsektorial në këshillin kombëtar sektorial dhe ndërsektorial pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare. Kryetari ka mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje një herë.

5. Pranë këshillave rajonale sektoriale dhe ndërsektoriale funksionojnë bordet e këshillave, të cilat zgjidhen me votë nga anëtarët e këshillit rajonal sektorial dhe ndërsektorial.

6. Rregullat e detajuara për ngritjen e këshillave sektorial e ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal, organizimi e veprimtaria e tyre dhe procesi zgjedhor përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

KREU V ARBITRAZHI

Neni 31

Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare ngren Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit të Dhomës Ekonomike Kombëtare, si person juridik.

2. Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit e Dhomës Ekonomike Kombëtare është kompetente për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat rrjedhin nga një marrëdhënie juridike e caktuar, që kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet subjekteve tregtare vendase dhe/ose të huaja, në përputhje me ligjin për arbitrazhin.

3. Rregullat e detajuara për ngritjen e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, forma e organizimit, veprimtaria, kompetencat dhe procedurat përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe në aktin e themelimit të kësaj gjykate.

KREU VI STATUTI

Neni 32

Statuti i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Veprimtaria e Dhomës Ekonomike Kombëtare, rregullat për zgjedhjen,

funksionimin dhe organizimin e organeve të saj, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet që ato nxjerrin, rregullohen nga statuti i Dhomës Ekonomike Kombëtare. Statuti duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi dhe përmban:

a) adresën e selisë së Dhomës Ekonomike Kombëtare, fushën e veprimtarisë, anëtarësimin, kriteret e tarifës sipas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të saj;

b) organizimin, funksionet, përbërjen dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese;

c) mënyrat e funksionimit të organeve drejtuese, ku përfshihen: rregullat, procedurat e zgjedhjes dhe të shkarkimit të organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe të komisionit të auditimit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për organet kolegjiale;

ç) burimet financiare, mënyrën e administrimit dhe të kontrollit të tyre, përfaqësimin dhe marrëdhëniet e Dhomës Ekonomike Kombëtare me të tretët;

d) rregullat për organizimin e mbledhjeve, njoftimin, pjesëmarrjen, mënyrën dhe procedurën e votimit për marrjen e vendimeve në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale;

dh) mënyrën e miratimit të ndryshimeve të statutit;

e) marrëdhëniet me ministrin përgjegjës për sipërmarrjen;

ë) sektorët, mënyrën e organizimit, funksionimit dhe procesit zgjedhor të këshillave sektorial e ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal;

f) kriteret për pjesëmarrjen në Këshillin Konsultativ;

g) rregullat bazë për mënyrën e funksionimit, organizimit dhe zgjedhjes të organeve drejtuese të dhomave ekonomike rajonale në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale;

gj) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj.

2. Asambleja, me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vetë, miraton statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

3. Dispozitat e këtij neni vlejné dhe për ndryshimet në statut.

Neni 33

Statuti i Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Veprimtaria e Dhomës Ekonomike Rajonale, rregullat për zgjedhjen, funksionimin dhe organizimin e organeve drejtuese të saj, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet që ato nxjerrin rregullohen nga statuti i Dhomës. Statuti duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare, si dhe i miratuar nga Asambleja e Dhomës Ekonomike Rajonale.

2. Statuti duhet të përfshijë:

a) adresën e selisë së Dhomës Ekonomike Rajonale, fushën e veprimtarisë, regjistrimin e subjekteve, kriteret dhe kuotën e regjistrimit, të drejtat dhe detyrat e subjekteve tregtare të saj.

b) mënyrën e organizimit, funksionet, përbërjen dhe përgjegjësitë e

organeve drejtuese;

c) mënyrat e funksionimit të organeve drejtuese, ku përfshihen rregullat, procedurat e zgjedhjes dhe të shkarkimit të organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Rajonale në përputhje me këtë ligj, legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale dhe Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare;

ç) burimet financiare që vijnë nga Dhoma Ekonomike Kombëtare dhe burimet e tjera, mënyrën e administrimit dhe të kontrollit të tyre, përfaqësimin dhe marrëdhëniet e Dhomës me të tretët;

d) rregullat për organizimin e mbledhjeve, njoftimin, pjesëmarrjen, mënyrën dhe procedurën e votimit për marrjen e vendimeve në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale;

dh) mënyrën e miratimit të ndryshimeve në statut;

e) marrëdhëniet me Dhomën Ekonomike Kombëtare;

ë) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj.

3. Statuti i Dhomës Ekonomike Rajonale miratohet me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Rajonale. Pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, statuti dërgohet pranë Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare për miratim lidhur mbi përputhshmërinë ligjore.

4. Në rastet kur Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare kërkon rishqyrtimin e statutit Dhoma Ekonomike Rajonale është e detyruar t'i nënshtrohet procesit të rishqyrtimit në zbatim të këtij ligji.

5. Dispozitat e këtij neni vlejné dhe për ndryshimet në statut.

KREU VII FINANCIMI DHE PRONA

Neni 34

Buxheti i Dhomës Ekonomike Kombëtare

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare, çdo vit kalendarik harton buxhetin e vet vjetor. Të ardhurat e Dhomës Ekonomike Kombëtare realizohen nëpërmjet:

a) tarifave vjetore të anëtarësisë;

b) tarifave për shërbimet që ajo ofron;

c) kontributeve të donatorëve vendas dhe të huaj;

ç) donacioneve të anëtarëve të saj;

d) burimeve të tjera, të cilat nuk bien ndesh me këtë ligj dhe ligje të tjera në fuqi.

2. Në çdo rast, buxheti vjetor duhet të garantojë funksionimin minimal të strukturave rajonale dhe sektoriale.

3. Me qëllim ofrimin e transparencës dhe të informimit të anëtarëve të saj e të publikut, Dhoma Ekonomike Kombëtare publikon çdo vit në faqen e saj të internetit buxhetin e vitit aktual të miratuar nga Asambleja dhe pasqyrën e realizimit faktik të buxhetit të vitit paraardhës.

Neni 35

Buxheti dhe Financimi i Dhomës Ekonomike Rajonale

1. Dhomat ekonomike rajonale, çdo vit kalendarik harton buxhetin e vet vjetor dhe ia dërgon atë Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare. Të ardhurat e dhomave ekonomike rajonale realizohen nëpërmjet:

- a) buxhetit të caktuar nga Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare në raport me numrin e anëtarëve të dhomës rajonale dhe prioriteteve në atë rajon;
- b) tarifave për shërbimet që ajo ofron;
- c) kontributeve të donatorëve vendas dhe të huaj;
- ç) donacioneve të anëtarëve të saj;
- d) burimeve të tjera, të cilat nuk bien ndesh me këtë ligj dhe ligje të tjera në fuqi.

2. Me qëllim ofrimin e transparencës dhe të informimit të anëtarëve të saj e të publikut, dhomat ekonomike rajonale publikojnë çdo vit në faqen e tyre të internetit buxhetin e vitit aktual të miratuar nga Asambleja e tyre dhe pasqyrën e realizimit faktik të buxhetit të vitit paraardhës

Neni 36

Tarifat e shërbimeve

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare mund të vendosë tarifa për shërbimet që ofron.

2. Vlera e tarifave përcaktohet me vendim të Bordit dhe me miratim të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

3. Për shërbimet publike të ofruara, Dhoma Ekonomike Kombëtare paraqet një raport vjetor pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, i cili monitoron ofrimin e këtyre shërbimeve.

Neni 37

Krijimi i të ardhurave dhe pasuritë e luajtshme e të paluajtshme

1. Dhoma Ekonomike Kombëtare në përmbushje të funksioneve të saj, ka të drejtën e krijimit, mbledhjes dhe shpenzimit të të ardhurave.

2. Dhoma Ekonomike Kombëtare ka të drejtë të fitojë dhe të krijojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me burime të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe administrohen prej saj, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dhoma Ekonomike Kombëtare si person juridik ushtron të gjitha të drejtat e njohura nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

KREU VIII
ZGJEDHJET, E DREJTA E VOTËS DHE KANDIDIMI

Neni 38

Zgjedhjet e organeve drejtuese

1. Zgjedhjet e organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare, Dhomave Ekonomike Rajonale, këshillave sektorial dhe ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal, sipas këtij ligji bazohen në përfaqësim proporcional të përgjithshëm, të barabartë dhe të fshehtë.

2. Të drejtat e votës të personave fizik dhe subjekteve të tjerë juridikë mund të ushtrohen nga përfaqësues me prokurë të shoqërisë që ato përfaqësojnë.

3. Përfshihen nga e drejta e votës edhe të gjithë personat fizik dhe juridik dhe subjektet e tjerë juridik për pasuritë e të cilëve janë në proces konfiskimi nga organet ligjzbatuese, janë hapur procedurat e falimentimit ose kanë pezulluar aktivitetin.

4. Dispozitat më të hollësishme për ushtrimin e të drejtës zgjedhore dhe për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve dhe emërimeve parashikohen në rregulloren e Komisioneve Zgjedhore të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 39

Organizimi i zgjedhjeve

1. Zgjedhjet e organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Dhomave Ekonomike Rajonale organizohen nga Komisioni i Zgjedhjeve 45 ditë përpara mbarimit të afatit 4 vjeçar.

2. Komisioni i Zgjedhjeve, për organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Dhomave Ekonomike Rajonale, cakton datën e zgjedhjeve dhe vepron në përputhje me rregulloren së zgjedhjeve të miratuar nga Asambleja e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Neni 40

Komisioni i Zgjedhjeve

1. Komisioni Zgjedhjeve ka për detyrë organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve të organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale.

2. Komisioni i Zgjedhjeve përbëhet nga një kryetar, zëvendësi i tij dhe 3 anëtarë të tjerë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Asambletë e Përgjithshme të Dhomave Ekonomike Rajonale.

3. Komisioni i zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe të Dhomave Ekonomike Rajonale janë përgjegjëse për:

a) shpalljen e zgjedhjeve;

b) shpalljen në formë elektronike të procedurave për zgjedhjet e organeve

drejtuese të dhomës;

c) përcaktimin e vendvotimeve, zonave të votimit, ditëve dhe orareve të votimit;

ç) shpall listën e subjekteve tregtare të regjistruara 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve;

d) shpall procedurën dhe metodikën për kandidimin në zgjedhje të organeve drejtuese;

dh) merr vendim për përshtatshmërinë e kandidatëve për zgjedhje dhe për vlefshmërinë e kandidaturave si dhe shpall rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se 10 ditë nga kryerja e tyre.

4. Komisioni i zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe të Dhomave Ekonomike Rajonale ngrihen 90 ditë përpara zgjedhjeve dhe e përfundojnë detyrën me certifikimin e rezultatit.

5. Rregulla më të hollësishme për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit zgjedhor, funksionimin dhe procedurën e certifikimit të rezultatit, përcaktohen në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 41

Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve ekzistuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë", të ndryshuar, duhet të paraqesin pranë Komisionit të Përkohshëm Teknik një raport të detajuar në lidhje me aktivitetin e tyre deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Komisioni i Përkohshëm Teknik, në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë", të ndryshuar, miraton planin e veprimit për periudhën tranzitore deri në certifikimin e zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

3. Me fillimin e procesit të parë zgjedhor, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë", të ndryshuar, do të vijojnë veprimtarinë e tyre në dakordësim të plotë me Komisionin e Përkohshëm Teknik.

4. Për të garantuar dhe siguruar një proces parazgjedhor dhe zgjedhor të paanëshëm, kushte dhe trajtim të barabartë të kandidatëve për organet drejtuese të dhomave ekonomike rajonale dhe Dhomës Ekonomike Kombëtare, gjatë periudhës 3 mujore të zgjedhjeve deri në certifikimin e zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare, veprimtaria e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që

kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, do të jetë e kufizuar sipas rregullave dhe përcaktimeve të miratuara në rregulloren e përkohshme zgjedhore, të parashikuar në nenin 44, pika 2, të këtij ligji.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji deri në zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, marrin përsipër të drejta dhe detyrime edhe të reja, si dhe kryejnë veprime financiare me palë të treta, me dakordësimin e kryetarit të Komisionit të Përkohshëm Teknik.

6. Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, përgatisin dhe dorëzojnë pasqyrat financiare brenda datës 31.1.2025.

Neni 42

Komisioni i Përkohshëm Teknik

1. Organizimi dhe funksionimi i plotë i Dhomës Ekonomike Kombëtare kalon në një periudhë kalimtare, e cila zgjat deri në 31 dhjetor 2025.

2. Drejtimi i veprimtarisë së Dhomës Ekonomike Kombëtare gjatë periudhës kalimtare kryhet nga Komisioni i Përkohshëm Teknik.

3. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ngarkohet të ngrejë Komisionin e Përkohshëm Teknik brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me përbërje si më poshtë:

a) 2 anëtarë ekspert në fushën e ekonomisë;

b) 1 anëtarë ekspert kontabilist;

c) 2 anëtarë ekspert jurist;

ç) 2 anëtarë nga Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark ose Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar.

4. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ka të drejtë të caktojë një përfaqësues për të ndjekur mbledhjet e Komisionit të Përkohshëm Teknik.

5. Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm Teknik nuk mund të jenë të zgjedhur në organet drejtuese të sistemit të dhomave të ngritura sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, si dhe nuk mund të kandidojnë në zgjedhjet e para për organe drejtuese në Dhomën Ekonomike Kombëtare dhe dhomat ekonomike rajonale.

6. Komisioni i Përkohshëm Teknik drejtohet nga Kryetari, i cili caktohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen, nga radhët e anëtarëve të këtij Komisioni, dhe përfaqëson Dhomën Ekonomike Kombëtare me palët e treta dhe aktivitetin kalimtar të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

7. Me certifikimin e zgjedhjeve, Komisioni i Përkohshëm Teknik kalon në

rol konsultativ të organeve të reja të zgjedhura.

8. Komisioni i Përkohshëm Teknik shkrihet automatikisht me miratimin e statutit të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe strategjisë afatmesëm të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

9. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen përcakton rregullat, kriteret dhe procedurën e zgjedhjes, si dhe shpërblimin financiar për anëtarët e Komisionit të Përkohshëm Teknik.

10. Komisioni i Përkohshëm Teknik me miratim të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen ka të drejtë të angazhojë për probleme të veçanta ekspertë shqiptarë dhe të huaj.

Neni 43

Detyrat e Komisionit të Përkohshëm Teknik

Komisioni i Përkohshëm Teknik realizon këto detyra:

a) brenda 3 muajve nga ngritja e tij, përgatit për ministrin përgjegjës për sipërmarrjen një raport për gjëndjen faktike juridike, administrative dhe financiare të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe të Bashkimit i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar;

b) brenda 3 muajve nga miratimi i këtij ligji, merr në dorëzim dokumentacionin zyrtar të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar;

c) bën njoftimin e palëve të treta për sistemin e ri të dhomave dhe ndërmerr veprimtari informuese për subjektet tregtare;

ç) ndihmon krijimin e sistemit të ri të dhomave dhe ndihmon në organizimin e zgjedhjeve të para të organeve drejtuese e vendimmarrëse të Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe krijimin e këshillave sektorial e ndërsektorial;

d) brenda 4 muajve nga ngritja e tij, harton dhe i propozon rregulloren e përkohshme për zgjedhjet, ministrit përgjegjës për sipërmarrjen;

dh) harton listën e anëtarëve që marrin pjesë në zgjedhjet e para dhe përgatit dokumentacionin për organizimin e zgjedhjeve në Dhomën Ekonomike Kombëtare, dhomat ekonomike rajonale dhe këshillat sektorial e ndërsektorial;

e) realizon shërbimet e detyrueshme për subjektet tregtare sipas legjislacionit në fuqi;

ë) ushtron funksionet e përkohshme administrativeve deri në zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

f) mbështet dhe ofron asistencë teknike për organet drejtuese të dala nga organizimi i zgjedhjeve të para për të hartuar projektet e statutit, rregulloret e brendshme dhe strategjinë e zhvillimit të Dhomës Ekonomike Kombëtare, si dhe projekt organigramën.

Neni 44

Organizmi i zgjedhjeve të para

1. Komisioni i Përkohshëm Teknik, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm zgjedhor, i cili organizon zgjedhjet e para të Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen miraton rregulloren e përkohshme zgjedhore të propozuar nga Komisioni Përkohshëm Teknik brenda 1 muaji. Komisioni i përkohshëm zgjedhor ka në përbërje 1 anëtar nga Komisioni i Përkohshëm Teknik, 1 person nga strukturat administrative të dhomave të krijuara sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, si dhe 1 anëtar të pavarur.

3. Komisioni i përkohshëm zgjedhor organizon zgjedhjet e para brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ky komision certifikon zgjedhjet dhe shkrihet automatikisht.

4. Në zgjedhjet e para kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë subjektet tregtare të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen, me propozim të Komisionit të Përkohshëm Teknik miraton me udhëzim sektorët e ekonomisë, për të cilat ngrihen këshillat e parë sektorial dhe ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal.

Neni 45

Financimi fillestar

1. Procesi kalimtar për ngritjen e Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial subvencionohet nga shteti deri në 31.12.2025, duke filluar që nga momenti i nisjes të punës së Komisionit të Përkohshëm Teknik.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e ligjit të miratojë buxhetin.

Neni 46

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për sipërmarrjen që të nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 4, pika 2; 36, pika 2; 42, pika 3, 6, 8 dhe 9; 44, pika 2 dhe 5, të këtij ligji.

Neni 47

Shfuqizime

Ligji nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, i

ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 48
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E T A R I
LINDITA NIKOLLA